



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI I ARTEVE
ADMINISTRATOR**

Nr. 1472 Prot.

Data 12/12/2018

NJOFTIM

Autoriteti kontraktor, Universiteti i Arteve, bazuar në legjislacionin në fuqi të prokurimit publik për procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksion i ndërtesës së korpusit kryesor të Universitetit të Arteve", fond limit prej 147.650.698 lekë pa TVSH dhe me Nr. Ref. 83353-08-20-2018, të publikuar në datën 22.08.2018 në sistemin e APP, njofton se për procedurën e sipërcituar është bërë publikimi i vlerësimit të dokumentacionit nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për Operatorët Ekonomik pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi dhe mbas publikimit të vlerësimit, pranë Autoritetit Kontraktor janë depozituar 2 ankesa nga Operatorët Ekonomik pjesmarrës.

Për sa më sipër, Autoriteti kontraktor, Universiteti i Arteve në pamundësi të shqyrtimit të ankesave për arsye të mungesës së personelit si ekspert i fushës, **Njofton** se kërkon 1 inxhinier ndërtimi ose inxhinier arkitekt dhe 1 specialist jurist për të marr pjesë në Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave që do të ngrihet sëbashku me personel të brendshëm.

Për inxhinierin e ndërtimit ose inxhinierin arkitekt, kriteret për pjesmarrje janë:

- Të paraqesë diplomë (fotokopje të noterizuar).
- Eksperiencë minimumi 3-vjet.
- Në rast se është në marrëdhënie punë në sektorin publik ose privatë të paraqesë vërtëtimin e punës.

Për specialistin jurist, kriteret për pjesmarrje janë:

- Të paraqesë diplomë (fotokopje të noterizuar).
- Eksperiencë minimumi 3-vjet.
- Të ketë dije mbi legjislacionin në fuqi mbi Prokurimin Publik.
- Në rast se është në marrëdhënie punë në sektorin publik ose privatë të paraqesë vërtëtimin e punës.

Të gjithë personat e interesuar për të marrë pjesë në Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave për këtë procedurë prokurimi duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar në Zyrën e Protokollit në Rektorat deri në datën 13.12.2018, ora 13:00.

ADMINISTRATOR

ALMA SINANAJ